



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KRYEMINISTRI**

**U R D H Ë R**

**Nr. 30, datë 17.2. 2021**

**PËR**

**PËRCAKTIMIN E GRUPIT TË KOORDINATORËVE PËR  
ZBATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT TË STRATEGJISË KOMBËTARE  
PËR DIASPORËN 2021-2025**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 12, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të vendimit nr. 585, datë 22.7.2020 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën dhe të Planit të Veprimit 2021-2025”,

**U R D H Ë R O J:**

1. Përcaktimin e Grupit të Koordinatorëve për zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2021-2025, miratuar me vendimin nr. 585, datë 22.07.2020, të Këshillit të Ministrave
2. Grupi i Koordinatorëve për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2021-2025, të kryesohet nga ministri i Shtetit për Diasporën dhe në përbërje të ketë këta anëtarë:
  - a) Zëvendësministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme.
  - b) Zëvendësministrin e Financave dhe Ekonomisë.
  - c) Zëvendësministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
  - d) Zëvendësministrin e Kulturës.
  - e) Zëvendësministrin e Turizmit dhe Mjedisit.



- f) Zëvendësministrin e Brendshëm.
  - g) Zëvendësministrin e Drejtësisë.
  - h) Zëvendësministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
  - i) Zëvendësministrin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
3. Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, të përfaqësohet nga Drejtori i Kabinetit. Akademia e Shkencave, INSTAT-i, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), dhe Agjencia Kombëtare për Diasporën do të përfaqësohen nga titullarët e vet.
  4. Institucionet përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë caktojnë edhe dy përfaqësues të tjerë (pika kontakti), specialistë të fushës, të cilët do të raportojnë periodikisht për realizimin e masave të përcaktuara në planin e veprimit.
  5. Koordinatorët janë përgjegjës për bashkërendimin e punës për zbatimin e masave të planit të veprimit në institucionin të cilin përfaqësojnë.
  6. Grupi i Koordinatorëve ka për detyrë:
    - a) ndjekjen dhe zbatimin e masave të përcaktuara në planin e veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2021-2025;
    - b) përcaktimin e detajimit të kostove dhe të indikatorëve për të gjitha masat e parashikuara në planin e veprimit.
  7. Koordinatorët të mbledhen jo më pak se një herë në muaj dhe sa herë është e nevojshme, me njoftim të kryetarit.
  8. Në mbledhjet e grupit të koordinatorëve mund të ftohen të marrin pjesë edhe ekspertë të strukturave të tjera, si organizata jofitimprurëse, organizmat ndërkombëtarë, universitetet dhe personalitete të fushës.



9. Ngarkohen titullarët e institucioneve të përmendura në pikën 2, të këtij urdhri, që, brenda 5 (pesë) ditësh nga hyrja në fuqi e tij, të caktojnë përfaqësuesit e tyre.
10. Urdhri nr.98, datë 16.7.2018, i Kryeministrit, “Për caktimin e grupit të koordinatorëve për zbatimin e planit të veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024”, shfuqizohet.
11. Ngarkohen ministri i Shtetit për Diasporën, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Kulturës, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, INSTAT-i, Akademia e Shkencave, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), Agjencia Kombëtare për Diasporën, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**